

SHOQËRIA “PËRPARIMI” SH.A.
SHKOZET – DURRËS

V E N D I M

**I ASAMBLESE SË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË “PËRPARIMI” SH.A.**

Sot më datën 16.07.2019, në selinë e shoqërisë “Përparimi”sh.a., në Shkozet, Durrës, u mbledh Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm:

- Shoqëria “**Feltex Holdings Limited**”, e cila zotëron 51% të aksioneve të shoqërisë, e përfaqësuar nga **Z.Mihal Delijorgji**, i biri i Pandeliut, i datëlindjes 1966, lindur në Terihat- Gjirokastër dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Kartës të Identitetit Nr. G60809021L, me anë të Vendimit të Drejtorit të Vetem të shoqërisë “**Feltex Holdings Limited**”, të datës 03.12.2018, autorizon **Z.Mihal Delijorgji** që të përfaqësojë shoqërinë “**Feltex Holdings Limited**” të firmosi në emër të saj dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme gjatë kësaj mbledhjeje të Asamblesë.

- **Z. Kristo Delijorgji**, i cili zotëron 49% të aksioneve, i pranishëm drejtpërsëdrejti.

- **Z.Sokol Plani**, administrator i shoqërisë, pa të drejtë vote.

Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë “Përparimi”sh.a. e mbledhur sot më datën 16.07.2019, në selinë e shoqërisë, në Shkozet, Durrës, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Administratori z.Sokol Plani, si më poshtë vijon:

1. Riemërimin e **Zj.Valbona Lloha** si anëtare e Këshillit Mbikqyrës me afat 3 vjeçar duke filluar nga data që i mbaron afati dt. 13/09/2018 deri me 13/09/2021.

KONSTATOI SE:

Shoqëria “Përparimi”sh.a., është një person juridik shqiptar, i regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 6657, dt.05.10.1994.

Lidhur me piken e rendit të ditës, aksionerët u shprehën se afati i anëtarit të



Këshillit Mbikqyrës Zj.Valbona Lloha ka perfunduar dhe duhet te rimerohet per nje afat 3 vjecar.

Për sa më lart në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e shoqërisë "Përparimi"sh.a.

VENDOSI:

1. Te rimerohet Zj.Valbona Lloha si anëtare e Këshillit Mbikqyrës me nje afat 3 vjecar nga dt.13/09/2018 deri me dt.13/09/2021.
2. Gjithë dokumentacioni i përgatitur për miratimin e vendimeve të mësipërme të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas kërkesave të Ligjit të Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar", si dhe statutit të shoqërisë.

Këto vendime u miratuan unanimitisht nga aksionarët.

AKSIONARËT

Për: "Feltex Holdings Limited"



Kristo DELIJORGJI



SHOQËRIA "PËRPARIMI" SH.A.

SHKOZET - DURRËS

V E N D I M

I ASAMBLESE SË AKSIONARËVE TË SHOQËRISË "PËRPARIMI" SH.A.

Sot më datën 24.06.2019, në selinë e shoqërisë "Përparimi"sh.a., në Shkozet, Durrës, u mbledh Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm:

- Shoqëria "**Feltex Holdings Limited**", e cila zotëron 51% të aksioneve të shoqërisë, e përfaqësuar nga **Z.Mihal Delijorgji**, i biri i Pandeliut, i datëlindjes 1966, lindur në Terihat- Gjirokastër dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Kartës të Identitetit Nr. G60809021L, me anë të Vendimit të Drejtorit të Vetem të shoqërisë "**Feltex Holdings Limited**", të datës 03.12.2018, autorizon **Z.Mihal Delijorgji** që të përfaqësojë shoqërinë "**Feltex Holdings Limited**" të firmosi në emër të saj dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme gjatë kësaj mbledhjeje të Asamblesë.

- **Z. Kristo Delijorgji**, i cili zotëron 49% të aksioneve, i pranishëm drejtpërsëdrejti.

- **Z.Sokol Plani**, administrator i shoqërisë, pa të drejtë vote.

Asambleja e Aksionarëve të Shoqërisë "Përparimi"sh.a. e mbledhur sot më datën 24.06.2019, në selinë e shoqërisë, në Shkozet, Durrës, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Administratori z.Sokol Plani, si më poshtë vijon:

- 1 Miratimi i shteses të Kapitalit nga fitimet e vitit 2018, pasi është zbritur shuma për krijimin e rezervave ligjore, si dhe nga fitimet e mbartura.
- 2 Caktimi i "Studio L.E.A.L. Auditing" për të përgatitur Raportin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me burim fitimet e realizuara nga aktiviteti gjatë vitit 2018 dhe fitimet e mbartura.

KONSTATOI SE:

Shoqëria "Përparimi"sh.a., është një person juridik shqiptar, i regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 6657, dt.05.10.1994.

Lidhur me piken e parë gjatë diskutimeve aksionarët ranë dakord që fitimet e vitit 2018 pasi të zbritet shuma për krijimin e rezervave ligjore të kalojë në shtesë të kapitalit në shumën prej 20.669.146 leke së bashku dhe me fitimet e mbartura (te pashperndara) deri më 31.12.2018 në shumën prej 330.854 leke.



Lidhur me piken e dyte gjatë diskutimeve aksionarët ranë dakord per ermirmin e ekspertit kontabel Znj.Leze Abazi, per hartimin e raportit te zmadhimit te kapitalit nga fitimet e vitit 2018 ne shumen prej 20.669.146 leke dhe nga fitimet e mbartura ne shumen prej 330.854 leke auditimin e Pasqyrave Finaciare te vitit 2019.

Për sa më lart në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e shoqërisë "Përparimi"sh.a.

VENDOSI:

1. Miratimin e shteses te Kapitalit nga fitimet e vitit 2018, pasi eshte zbritur shuma per krijimin e rezervave ligjore, si dhe nga fitimet e mbartura.
2. Miratimin e ekspertin kontabel "Studio L.E.A.L. Auditing" per te pregatitur Raportin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise me burim fitimet e realizuara nga aktiviteti gjate vitti 2018 ne shumen prej 20.669.146 leke dhe nga fitimet e mbartura ne shumen prej 330.854 leke.
3. Vendimi i mësipërm të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si prane Drejtorise Rajonale Ttaimore sipas kërkesave të Ligjit të Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar".

Këte vendim e miratuan unanimitisht nga aksionarët.

AKSIONARËT

Për: "Feltex Holdings Limited"



Kristo DELIJORGJI



SHOQËRIA “PËRPARIMI” SH.A.
SHKOZET – DURRËS

V E N D I M

**I ASAMBLESE SË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË “PËRPARIMI” SH.A.**

Sot më datën 27.06.2019, në selinë e shoqërisë “Përparimi”sh.a., në Shkozet, Durrës, u mbledh Asambleja e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm:

- Shoqëria **“Feltex Holdings Limited”**, e cila zotëron 51% të aksioneve të shoqërisë, e përfaqësuar nga **Z.Mihal Delijorgji**, i biri i Pandeliut, i datëlindjes 1966, lindur në Terihat- Gjirokastër dhe banues në Tiranë, identifikuar me anë të Kartës të Identitetit Nr. G60809021L, me anë të Vendimit të Drejtorit te Vetem te shoqërisë **“Feltex Holdings Limited”**, të datës 03.12.2018, autorizon **Z.Mihal Delijorgji** që të përfaqësojë shoqërinë **“Feltex Holdings Limited”** të firmosi në emër të saj dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme gjatë kësaj mbledhjeje të Asamblesë.

- **Z. Kristo Delijorgji**, i cili zotëron 49% të aksioneve, i pranishëm drejtpërsëdrejti.

- **Z.Sokol Plani**, administrator i shoqërisë, pa të drejtë vote.

Asambleja e Aksionarëve te Shoqërisë “Përparimi”sh.a. e mbledhur sot më datën 27.06.2019, në selinë e shoqërisë, në Shkozet, Durrës, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Administratori z.Sokol Plani, si më poshtë vijon:

1. Miratimi i raportit të hartuar nga eksperti kontabël për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me burim fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë gjatë vitit 2018, pasi janë zbritur shuma për rezerva ligjore, si dhe nga fitimet e mbartura deri më 31.12.2018.
2. Miratimin e kapitalit të shoqërisë së bashku me shtesën e kapitalit gjithsej në total prej 426.000.000 lek, i përbërë nga 11.360 aksione me vlerë prej 37.500 lek secili aksion.



KONSTATOI SE:

Shoqëria "Përparimi"sh.a., është një person juridik shqiptar, i regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare, me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 6657, dt.05.10.1994.

Lidhur me piken e parë të rendit të ditës, aksionerët u shprehën për miratimin e raportit të hartuar nga eksperti kontabël për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me burim fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë gjatë vitit 2018, pasi janë zbritur shuma për rezerva ligjore, si dhe nga fitimet e mbartura deri më 31.12.2018 në shumën prej 330.854 leke.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, aksionarët u shprehën dakord për miratimin e kapitalit të shoqërisë së bashku me shtesën e kapitalit gjithsej në total prej 426.000.000 lek, i përbërë nga 11.360 aksione me vlerë prej 37.500 lek secili aksion.

Për sa më lart në mbështetje të Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e shoqërisë "Përparimi"sh.a.


VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të ekspertit kontabel për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.
2. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë në shumën prej **21.000.000 lek** sipas raportit të ekspertit kontabël me burim fitimet e vitit 2018, pasi janë zbritur shuma për rezerva ligjore dhe nga fitimet e mbartura.
 - a. Kapitali i shoqërisë së bashku me shtesën **behët 426.000.000 lek** (ishte 405.000.000 lek dhe behët prej 426.000.000 lek) i përbërë nga **11.360 aksione** me vlerë prej 37.500 lek secili aksion, dhe zotërohet nga aksionarët sipas përqindjeve të pjesëmarrjes:
 - Shoqëria "**Feltex Holdings Limited**", e cila zotëron 51% të kapitalit, ose në vlefte prej **217.260.000 lek**, e përbërë nga **5.793,6 aksione**,
 - Z. Kristo Delijorgji**, i cili zotëron 49% të kapitalit, ose në vlefte prej **208.740.000 lek**, e përbërë nga **5.566,4 aksione**.
3. Gjithë dokumentacioni i përgatitur për miratimin e vendimeve të mësipërme të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas kërkesave të Ligjit të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar", si dhe statutit të shoqërisë.

Këto vendime u miratuan unanimisht nga aksionarët.

AKSIONARËT

Për: "**Feltex Holdings Limited**"



Për: **Kristo DELIJORGJI**

